

Në bazë të nenit 2 paragrafi 15 të Ligjit për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional në shkollat fillore dhe të mesme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/19), Rregullorja mbi Programin për dhënien e provimit profesional për mësimdhënësit-praktikantë dhe bashkëpunëtorë profesional-praktikantë dhe për mënyrën e realizimit të provimit profesional ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 121/20), në lidhje me nenin 6 dhe nenin 21 nënpikën 4.1 të Rregullores për mënyrën, procedurën dhe kriteret e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe përcaktimit të lartësisë së honorarëve dhe kompensimeve për shërbimet e tjera të Qendrës Shtetërore të Provimeve nr. 01-440/3, datë 28.12.2022., u.d. drejtori i Qendrës Shtetërore të Provimeve, solli:

KONKURS

për përzgjedhjen e kryetarëve dhe zëvendës-kryetarëve të komisioneve profesionale

Qendra Shtetërore e Provimeve përsëri shpall Konkurs për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm - kryetarë dhe zëvendës-kryetarë të komisioneve profesionale për realizimin e provimit të praktikantit për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional nga shkollat fillore dhe të mesme, sa vijon:

1. **GJUHË MAQEDONASE** dhe **GJUHË MAQEDONASE DHE LETËRSI** - një bashkëpunëtor i jashtëm në gjuhën mësimore maqedonase.
2. **GJUHË SHQIPE** dhe **GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI** - dy bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore shqipe.
3. **GJUHË TURKE** dhe **GJUHË TURKE DHE LETËRSI** - dy bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore turke.
4. **GJUHË DHE KULTURË SERBE, ROME, BOSHNJAKE, VLLAHE** - dy bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore serbe/rome/boshnjake ose vllahe.
5. **MËSIMDHËNËS PËR GRUPIN KLASOR NË GJUHËN TURKE** - dy bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore turke.
6. **INFORMATIKË** - një bashkëpunëtor i jashtëm në gjuhën mësimore shqipe.
7. **FIZIKË** - dy bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe).
8. **KIMI** dhe **SHKENCAT E NATYRËS** - dy bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe).
9. **BIOLOGJI** - dy bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe).
10. **GJEOGRAFI** - dy bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe).
11. **HISTORI** - një bashkëpunëtor i jashtëm në gjuhën mësimore shqipe.
12. **SOCIOLOGJI, SOCIOLOGË, PUNONJËS SOCIAL, ARSIMI QYTETAR** dhe **KULTURA QYTETARE** - dy bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe).
13. **NJOHJA E RELIGJIONEVE, ETIKA E RELIGJIONEVE, ETIKË** dhe **PAQJA DHE TOLERANCA** - dy bashkëpunëtorë i jashtëm në gjuhën mësimore shqipe).
14. **FILOZOFI, LOGJIKË, ESTETIKË** - një bashkëpunëtor i jashtëm në gjuhën mësimore shqipe.
15. **KULTURA KLASIKE E CIVILIZIMIT EVROPIAN** dhe **GJUHË LATINE** - dy bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe).
16. **GJUHË ANGLEZE** një bashkëpunëtor i jashtëm në gjuhën mësimore shqipe.
17. **GJUHË ITALIANE** dy bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore maqedonase.
18. **GJUHË FRENGE** dy bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe).
19. **GJUHË GJERMANE** një bashkëpunëtor i jashtëm në gjuhën mësimore shqipe.
20. **GJUHË RUSE** dy bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore maqedonase.
21. **EDUKIMI FIZIK DHE SHËNDETËSOR** - dy bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore shqipe.

- 22. ARSIMI TEKNIK** - *dy bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe).*
- 23. ART FIGURATIV, ARSIM FIGURATIV DHE ARSIM ARTISTIK – ART FIGURATIV DHE DIZAJN** – *dy bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe).*
- 24. ART MUZIKOR, ARSIM MUZIKOR, ARSIM ARTISTIK – ART MUZIKOR DHE BALET** – *dy bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe).*
- 25. PSIKOLOGJI dhe PSIKOLOGË** – *dy bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe).*
- 26. PEDAGOGJI dhe PEDAGOGË** – *një bashkëpunëtorë i jashtëm në gjuhën mësimore shqipe.*
- 27. EDUKATOR SPECIAL (DEFEKTOLOGË, LOGOPEDISTË)** – *një bashkëpunëtor i jashtëm në gjuhën mësimore shqipe.*
- 28. BIBLIOTEKAR** - *dy bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe).*
- 29. PROFESIONI/SEKTORI: SHËNDETI/SHËNDETI DHE MIRËQENIA SOCIALE** dhe **PROMOVIMI I SHËNDETIT PUBLIK** - *dy bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe).*
- 30. PROFESIONI/SEKTORI: PYLLTARI-PËRPUNIM DRURI/PYLLTARI DHE PËRPUNIM DRURI** - *dy bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore maqedonase.*
- 31. PROFESIONI/SEKTORI: HOTELIERIK-TURISTIK/HOTELIERI** dhe **TURIZËM**- *dy bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe).*
- 32. PROFESIONI/SEKTORI: BUJQËSI-VETERINARI/BUJQËSI, PESHKATARI DHE VETERINARI** – *dy bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe).*
- 33. PROFESIONI/SEKTORI: KIMI-TEKNOLOGJI/KIMI DHE TEKNOLOGJI** - *një bashkëpunëtor i jashtëm në gjuhën mësimore maqedonase.*
- 34. PROFESIONI/SEKTORI: TEKSTIL-LËKURË/TEKSTIL, LËKURË DHE PRODUKTE TË NGJASHME** - *dy bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe).*
- 35. PROFESIONI/SEKTORI: GJEOLOGJI-MINERARI DHE METALURGJI/GJEOLOGJI, MINERARI DHE METALURGJI** - *dy bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore maqedonase.*
- 36. PROFESIONI/SEKTORI: TRAFIK/TRAFIK, TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI** – *dy bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe).*
- 37. PROFESIONI/SEKTORI: MAKINERI/MAKINERI** – *dy bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe).*
- 38. PROFESIONI/SEKTORI: ELEKTROTEKNIKË/ELEKTROTEKNIKË** – *një bashkëpunëtor i jashtëm në gjuhën mësimore shqipe.*
- 39. PROFESIONI/SEKTORI: EKONOMI-JURIDIK DHE TREGTI/EKONOMI, JURIDIK E TREGTI** dhe **INOVACIONE** - *një bashkëpunëtor i jashtëm në gjuhën mësimore shqipe.*
- 40. PROFESIONI/SEKTORI: GRAFIKË/GRAFIKË** – *dy bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore maqedonase.*
- 41. PROFESIONI/SEKTORI: SHËRBIME PERSONALE** – *dy bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe).*

Kualifikimet e nevojshme:

Kandidatët që aplikojnë për kryetarë dhe zëvendës-kryetarë të komisioneve profesionale për realizimin e provimit të praktikantit, duhet të plotësojnë këto kushte:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të kenë të kryer të paktën studime akademike të ciklit të parë në lëndën përkatëse, gjegjësisht profesionin/sektorin përkatës;

- të jenë nga radha e mësimdhënësve të lëndës/profesionit/sektorit adekuat/e në shkolla fillore/të mesme në RMV ose të jenë nga radha e bashkëpunëtorëve profesional në shkolla fillore/të mesme në RMV;
- vërtetim për marrëdhënie të përherershme në origjinal për përvojë pune 7 vjet në një institucion arsimor të verifikuar dhe/ose mësimdhënës nga institucione të arsimit të lartë të akredituar nga fusha përkatëse;
- të kenë përvojë si mentor praktikant.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- fletë aplikimi (formulari i vendosur në ueb-faqen e Qendrës Shtetërore të Provimeve);
- një kopje të noterizuar të certifikatës/diplomës së arsimit të lartë përkatës;
- certifikatë origjinale e punësimit të rregullt dhe përvojë pune të përshtatshme prej së paku 7 vitesh si mësimdhënës/bashkëpunëtor profesional në veprimtarinë edukative-arsimore, të lëshuar nga shkollat fillore/të mesme në RMV;
- dëshmi e realizimit të mentorimit (vendim për caktimin si mentor dhe programi për mbështetjen e praktikantit).

Qendra Shtetërore e Provimeve do të bëjë përzgjedhje sipas kriterieve të mësipërme, kurse kandidatët që do të hyjnë në rrithin e dytë do të intervistohen, pas së cilës do të vijojë përzgjedhja përfundimtare.

Kandidatët që do të përzgjidhen për kryetarë dhe zëvendës-kryetarë të komisioneve profesionale për realizimin e provimit të praktikantit për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional do të angazhohen për një periudhë prej **dy vjetësh**.

Kandidatët e interesuar mund të dorëzojnë dokumentet e duhura **më së voni deri më 16.2.2023**.

Dokumentacioni i dërguar pas afatit, i pavlefshëm dhe i paplotë nuk do të merret parasysh.

Fletë aplikimi me dokumentacionin e duhur dërgohet me postë të rekomanduar në adresën: Qendra Shtetërore e Provimeve - Shkup, rr. "Vasil Gjorgov" p.n. 1000 Shkup, me shënimin për konkursin publik për kryetarë dhe zëvendës-kryetarë të komisioneve profesionale për realizimin e provimit të praktikantit.

Informacione shtesë mund të merrni në numrin e telefonit 075/300-606, çdo ditë pune.

QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE